



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale
Mbledhja nr. 23
Prishtinë, 11 nëntor 2008, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

P R O C E S V E R B A L

i mbledhjes së Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Në mbledhje morën pjesë: Sadik Idriz, Rita Hajzeraj, Flora Brovina, Gjylnaze Sylja, Mimoza Ahmetaj, Armend Zemaj, Bujar Bukoshi dhe Teuta Hadri.

Munguan: Qamile Morina, Nurishahe Hulaj dhe Sllobodan Petroviq.

Të pranishëm:

Nga Zyra e Komisioneve të Kuvendit: Shpresa Haxhijaj - administratore dhe Fatime Qorri - zyrtare ligjore.

Nga NDI-ja: Shefki Kastrati

Nga OSBE-ja: Lejla Selimi

Nga KDI-ja: Rrezarta Ahmeti

Mbledhjen e kryesoi z. Sadik Idriz, kryetar i Komisionit.

Komisioni i zhvilloi punimet me këtë

REND DITE

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit për rehabilitimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara;**
- 4. Të ndryshme.**

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet dhe e hapi mbledhjen lidhur me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

Kryesuesi konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së kaluar pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për rehabilitimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara

Sadik Idriz –Tha se Komisioni e ka ngarkuar grupin e punës për shqyrtimin dhe amendamentimin e propozimeve të Ministrisë së Punës dhe të Mirëqenies Sociale. Raportuese e këtij grupi është deputetja Flora Brovina.

Flora Brovina – raportuese e grupit të punës – Tha se grupi i punës është takuar dhe i ka përgatitur propozimamendamentet. Ky grup pune ka pasur dilema rreth dy çështjeve. Dilema e parë ka qenë propozimamendamenti 12 i deputetes Teuta Hadri për themelimin e një qendre koordinuese – qendër ndërlidhëse ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, Qendrës së Aftësimit Profesional, Qendrës për Rehabilitim Profesional, qendrave rajonale të punësimit dhe të zyrave komunale të punësimit. Kjo qendër drejtpërsëdrejti i përgjigjet Qeverisë. Grupi i punës nuk ka deklaruar financiare lidhur me këtë propozimamendament, prandaj grupi i punës nuk ka diskutuar për këtë propozimamendament, pasi i është lënë Komisionit të debatohet lidhur me këtë propozim.

Dilema e dytë ka qenë - përfaqësuesit e personave me aftësi të kufizuara kërkojnë ta kenë një linjë buxhetore, por këtë nuk e lejon Ligji për menaxhimin e financave publike.

Ajo i paraqiti propozimamendamentet e grupit të punës.

Amendamentet për të cilat u debatua në mbledhjen e Komisionit ishin: 11, 12 dhe 31.

Amendamenti 11

Në nenin 3, pas pikës 14, shtohet një pikë e re me përmbajtje:

„Asistenti është person i domosdoshëm për personin e caktuar, pa të cilin personi me aftësi të kufizuara nuk mund të aftësohet ose të riaftësohet për punë, ose të krijojë marrëdhënie pune”.

Gjynaze Syla – Për propozimamendamentin 11 e propozoi këtë riformulim: *„Asistenti është person i domosdoshëm për personin me aftësi të kufizuara që nuk mund të aftësohet, të riaftësohet për punë ose të krijojë marrëdhënie pune“.*

Sadik Idriz - Propozoi që propozimamendamenti 11 ta ketë këtë riformulim: *“Asistenti është person, pa të cilin personi me aftësi të kufizuara nuk mund të aftësohet ose të riaftësohet për punë, ose të krijojë marrëdhënie pune“.*

Flora Brovina – E propozoi këtë riformulim për propozimamendamentin 11: *“Asistenti është person i domosdoshëm, pa të cilin personi me aftësi të kufizuara nuk mund të aftësohet ose të riaftësohet për punë, ose të krijojë marrëdhënie pune“.*

Kryesuesi konstatoi se Komisioni e miratoi propozimin e deputetes Flora Brovina.

Amendamenti 12

Në nenin 3 të Projektligjit, pas pikës 21, shtohet një pikë e re me këtë përmbajtje:

„Qendra koordinuese” – është qendër e koordinimit ndërlidhës ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, Qendrës së Aftësimit Profesional, Qendrës për

Rehabilitim Profesional, qendrave rajonale të punësimit dhe zyrave komunale të punësimit. Kjo qendër drejtpërsëdrejti i përgjigjet Qeverisë”.

Teuta Hadri – Tha se e ka propozuar amendamentin 12, me qëllim të përkrahjes së kësaj kategorie të njerëzve. Ky propozim është në përputhshmëri me deklaratën e Salamonës dhe nuk ka implikime të mëdha buxhetore, sepse qendrat e tjera ekzistojnë, por nevojitet vetëm një qendër koordinuese që i mbështet kërkesat e kësaj kategorie të njerëzve. Kjo kategori e njerëzve duhet ta ketë buxhetin e vet dhe ta menaxhojë vetë atë buxhet.

Armend Zemaj – Edhe pse qëllimi i propozimamendamentit të 12 është i mirë, megjithatë ky amendament do të reflektojë si një përzierje e kompetencave. Edhe nëse përkrahet ky propozim, problem do të jetë zbatimi i tij. Sipas propozimit kjo qendër i përgjigjet drejtpërsëdrejti Qeverisë. Qeveri janë edhe Ministria e Shëndetësisë, edhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Kush e merr të drejtën ta udhëheqë këtë qendër, nuk përkrah diçka që nuk do të mund të zbatohet.

Bujar Bukoshi – Tha se i kemi disa standarde që synojmë t’i realizojmë, andaj propozoi të lihet si opsion i hapur mundësia e themelimit të kësaj qendre koordinuese.

Gjylnaze Syla – Tha se qëllimi i propozimamendamentit është i mirë. Formulimi është i paqartë, konfuz dhe i pazbatueshëm. Nuk e mbështes këtë propozim. Ekziston Këshilli Nacional për këtë kategori të njerëzve.

Rita Hajzeraj – Tha, secila qendër i përgjigjet një ministrie të veçantë. Nëse bëhet edhe një qendër koordinuese, po krijojmë paralelizëm dhe nuk ka vend për përgjegjësi.

Kryesuesi i ftoi anëtarët e Komisionit të votojnë për propozimamendamentin 12.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni me shumicë votash e kundërshtoi propozimamendamentin 12.

Propozimamendamenti 12 do të procedohet tutje si propozim i deputetes Teuta Hadri pa përkrahjen e Komisionit Funkcional.

Amendamenti 30

Në nenin 18, pas paragrafit 3, shtohet një paragraf i ri me këtë përmbajtje:

„Për personin me aftësi të kufizuara, 100% shfrytëzues i pensionit për aftësisë së kufizuara, pensioni të shndërrohet në asistencë personale për ndihmësin në punë (asistentin e tij)”.

Sadik Idriz – Tha se propozimamendamenti 30 është i vetmi amendament për të cilin Komisioni për Buxhet dhe Financa ka pasur vërejtje se ka implikime buxhetore. Propozoi që ky amendament të mos përkrahet, sepse ka implikime buxhetore ose ta bëjmë një konsultim me Komisionin për Buxhet dhe Financa për implikimet e këtij propozimamendamenti.

Flora Brovina – Tha se pikërisht për propozimamendamentin 30 grupi i punës ka kërkuar deklaratë financiare nga Ministria e Ekonomisë dhe e Financave, por përgjigje nuk ka marrë. Propozoi që ky propozimamendament të përkrahet, sepse disa njerëz të kësaj kategorie mund të kenë nevojë për përkrahje të asistentit në punët e tyre të përditshme që duhet të paguhet për punën që e bën.

Rita Hajzeraj – Pyeti, si është e mundur që pensioni i personit me aftësi të kufizuara të shndërrohet në asistencë sociale për asistentin e tij?

Kryesuesi i ftoi anëtarët e Komisionit të votojnë për propozimamendamentin 30.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni e miratoi propozimamendamentin 30.

Kryesuesi i ftoi anëtarët e Komisionit të votojnë për amendamentet e propozuara si tërësi:

Amendamenti 1

Pjesa e parë e preambulës riformulohet:

Në bazë të nenit 65, pika (1), të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Komisioni FunkSIONAL

Amendamenti 2

Titulli i Projektligjit riformulohet:

„Projektligji për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara”.

Komisioni FunkSIONAL

Amendamenti 3

Në tërë tekstin e P/ligjit fjala „rehabilitim” të zëvendësohet me fjalët „aftësim , riaftësim”.

Komisioni FunkSIONAL

Amendamenti 4

Neni 2 riformulohet:

Qëllimi i këtij projektligji është përkrahja ligjore dhe institucionale për aftësimin, riaftësimin, nxitjen dhe përgatitjen profesionale për punësim të përshtatshëm për personat me aftësi të kufizuara, duke u mbështetur në principet dhe tretmanin e mundësive të barabarta, përfshirë edhe mundësitë gjinore.

Komisioni FunkSIONAL

Amendamenti 5

Në nenin 3, pika 2, riformulohet:

„Person me aftësi të kufizuara për punë, është personi me aftësi të kufizuara, aftësia e të cilit në raport me aftësinë e personit që nuk ka aftësi të kufizuara të së njëjtës moshë ose të përafërt, me edukim të njëjtë ose të përafërt, me kushte të njëjta të punës ose të përafërta, në punë të njëjtë ose të përafërt, i ka si pasojë aftësitë e kufizuara të përhershme, ose së paku 12 muaj, mundësinë e zvogëluar për aftësim, mundësinë e zvogëluar të punësohet dhe të punojë në tregun e punës me kushte të përgjithshme dhe të barabarta”.

Komisioni FunkSIONAL

Amendamenti 6

Në nenin 3, në pikën 5, në rreshtin e parë hiqet fjala „element” dhe zëvendësohet me fjalën “proces”, kurse në rreshtin e dytë hiqet fjala “e shkathtësive”.

Komisioni FunkSIONAL

Amendamenti 7

Në nenin 3, në pikën 6, në rreshtin e parë, pas fjalës „mjekësorë” shtohen fjalët „dhe lëmenjve të tjerë” dhe vazhdon teksti si në P/ligj.

Komisioni FunkSIONAL

Amendamenti 8

Në nenin 3, pika 11 riformulohet:

„Trajneri është person profesionist i certifikuar i punës, i përgatitur dhe i ngarkuar për ofrimin e ndihmës për aftësim dhe riaftësim profesional për personin me aftësi të kufizuara, në pajtim me kërkesat e vendeve të punës në tregun e hapur të punës”.

Komisioni FunkSIONAL

Amendamenti 9

Në nenin 3, pika 12 riformulohet:

„Aftësimi dhe riaftësimi profesional i nënkuptojnë të gjitha aktivitetet që synojnë të sigurojnë njohuri, aftësim dhe përvojë të re për aftësim të nevojshëm, për punë efektive brenda profesionit që e ka kryer edhe më parë, para aftësisë së kufizuar, ose riaftësimit për një profesion të ri që mund ta bëjë me sukses”.

Komisioni FunkSIONAL

Amendamenti 10

Në nenin 3, pas pikës 14, shtohet një pikë e re me këtë përmbajtje:

„Asistenti është person i domosdoshëm, pa të cilin personi me aftësi të kufizuara nuk mund të aftësohet ose të riaftësohet për punë, ose të krijojë marrëdhënie pune”.

Komisioni FunkSIONAL

Amendamenti 11

Në nenin 3 të Projektligjit, pas pikës 21, shtohet një pikë e re me këtë përmbajtje:

„Qendra koordinuese” – është qendër koordinimi ndërlidhëse ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, Qendrës së Aftësimit Profesional, Qendrës për Rehabilitim Profesional, qendrave rajonale të punësimit dhe zyrave komunale të punësimit. Kjo qendër drejtpërsëdrejti i përgjigjet Qeverisë.

Deputetja: Teuta Hadri (pa përkrahjen e Komisionit funksional)

Amendamenti 12

Në nenin 4, pika 1 riformulohet:

„Personi me aftësi të kufizuara, shfrytëzues i mjeteve financiare, që realizon të drejta dhe përfitime sipas dispozitave ligjore për ndihmë sociale dhe pensione të personave me aftësi të kufizuara”.

Komisioni FunkSIONAL

Amendamenti 13

Në nenin 4, pika 4 riformulohet:

„Nxënësi prej moshës 15 - 18 vjeç, me aftësi të kufizuara mendore, fizike, psikike ose të kombinuara, sipas dispozitave ligjore të aplikueshme për shkollimin e mesëm, duke i siguruar atij që ka nevojë edhe gjuhën e shenjave për personin e shurdhët dhe alfabetin e Brajtit për të verbrit”.

Komisioni Funksional

Amendamenti 14

Në nenin 5, paragrafi 3 hiqet.

Komisioni Funksional

Amendamenti 15

Në titullin e kapitullit III hiqen fjalët „CAKTIMIN E PAFTËSISË” dhe zëvendësohen me “VLERËSIMIN E AFTËSISË”.

Komisioni Funksional

Amendamenti 16

Në nenin 6, paragrafi 1 bëhet 2, ndërsa paragrafi 2 bëhet 1.

Komisioni Funksional

Amendamenti 17

Në nenin 6, paragrafi 3 riformulohet:

„Nisma për fillimin e procedurës për njohjen e së drejtës nga paragrafi 1 i këtij neni, paraqitet me kërkesën e personit me aftësi të kufizuara. Në pamundësi të nismës për fillimin e procedurës nga ana e personit me aftësi të kufizuara, nismën për procedurë e marrin familja e tij e ngushtë, përfaqësuesi ligjor, mbrojtësi i tij ose personi i tretë”.

Komisioni Funksional

Amendamenti 18

Në nenin 6, paragrafi 4 riformulohet :

“Kërkesa për procedurë për vlerësimin e zvogëlimit të aftësisë së kufizuar për punë mund të bëhet në bazë të kërkesës së personit me aftësi të kufizuara, të anëtarit të familjes së ngushtë, të përfaqësuesit të tij ligjor ose të kujdestarit të tij”.

Komisioni Funksional

Amendamenti 19

Në nenin 7, paragrafi 3, në rreshtin e tretë pas fjalës “të drejtës” të shtohet fjala “për punë” vazhdon teksti si në P/ligj.

Komisioni Funksional

Amendamenti 20

Në nenin 8, paragrafi 1, në rreshtin e katërt hiqet fjala “të peshës” dhe zëvendësohet me fjalën “të shkallës”.

Komisioni FunkSIONAL

Amendamenti 21

Në nenin 10, pika 2 riformulohet:

„Parimet, mënyra e veprimit dhe metodat e përgatitjes profesionale të zbatuara përgjithësisht për kualifikime të personave të tjerë, zbatohen në rastet e personit me aftësi të kufizuara, deri në atë masë sa lejojnë aftësitë e tij.

Komisioni FunkSIONAL

Amendamenti 22

Në nenin 12, paragrafi 2 riformulohet „Çdo punëdhënës është i obliguar ta punësojë një person me aftësi të kufizuara në çdo 50 punëtorë”.

Komisioni FunkSIONAL

Amendamenti 23

Në nenin 12, paragrafi 3 riformulohet „Punëdhënësi që nuk i përmbush detyrimet nga paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, obligohet që për nxitjen e punësimit të personave me aftësi të kufizuara të paguajë në buxhetin e Kosovës kontribute mujore në lartësi 1% të shumës së pagës minimale.

Komisioni FunkSIONAL

Amendamenti 24

Në nenin 13, paragrafi 4, në rreshtin e dytë hiqet fjala „mund të”.

Komisioni FunkSIONAL

Amendamenti 25

Titulli i nenit 14 riformulohet:

Qendra për Aftësim, Riaftësim Profesional dhe Punësim e Kosovës.

Komisioni FunkSIONAL

Amendamenti 26

Paragrafi 2 i nenit 14 kalon në paragrafin 1 dhe riformulohet: „Qendra për Aftësim, Riaftësim Profesional dhe Punësim e Kosovës është në kompetencë të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale”.

Komisioni FunkSIONAL

Amendamenti 27

Në nenin 14, paragrafët 3 dhe 4 hiqen .

Komisioni FunkSIONAL

Amendamenti 28

Në nenin 14, paragrafi 6 hiqet.

Komisioni Funksional

Amendamenti 29

Në nenin 14, në fund të paragrafit 7, shtohen fjalët „të nxjerrë nga MPMS-ja“

Komisioni Funksional

Amendamenti 30

Neni 18 hiqet dhe riformulohet „Punëdhënësi që punëson persona me aftësi të kufizuara, si dhe personi me aftësi të kufizuara që ushtron veprimtari të pavarur, të drejtën për lehtësime doganore dhe tatimore e realizojnë sipas ligjeve tatimore dhe doganore në fuqi“.

Komisioni Funksional

Amendamenti 31

Në nenin 18, pas paragrafit 3, shtohet një paragraf i ri me këtë përmbajtje:

„Për personin me aftësi të kufizuara, 100% shfrytëzues i pensionit të aftësisë së kufizuar, pensioni të shndërrohet në asistencë personale për ndihmësin në punë (asistentin e tij)“.

Komisioni Funksional

Amendamenti 32

Neni 19 hiqet .

Komisioni Funksional

Amendamenti 33

Në nenin 20, në paragrafin 3, hiqet teksti „nënkodit buxhetor për rehabilitim profesional dhe punësim të personave me aftësi të kufizuara“ dhe zëvendësohet me „buxhetit të Kosovës“

Komisioni Funksional

Amendamenti 34

Në nenin 20, paragrafi 5, hiqet fjalia „Autorizohet zyrtari përgjegjës i nënkodit buxhetor për rehabilitim profesional dhe punësim të personave me aftësi të kufizuara“ dhe zëvendësohet me “autorizohen organet kompetente“.

Komisioni Funksional

Amendamenti 35

Neni 21 hiqet.

Komisioni Funksional

Amendamenti 36

Neni 24 hiqet.

Komisioni Funksional

Amendamenti 37

Në nenin 25, paragrafi 7, hiqet fjalia „barten në nënkodin buxhetor për rehabilitim profesional dhe punësim të personave me aftësi të kufizuara,, dhe zëvendësohet me „barten në buxhetin e Kosovës dhe përdoren për aftësim, riaftësim profesional dhe punësim të personave me aftësi të kufizuara”.

Komisioni Funksional

Amendamenti 38

Titulli i nenit 27 hiqet.

Komisioni Funksional

Amendamenti 39

Në nenin 27, paragrafi 1 riformulohet „Financimi për aftësimin, riaftësimin dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara bëhet nga buxheti i Kosovës”.

Komisioni Funksional

Amendamenti 40

Në nenin 27, paragrafi 2 riformulohet:

„Buxhetin për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara, e menaxhon dhe mbikëqyr Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale e Kosovës”.

Komisioni Funksional

Amendamenti 41

Në nenin 27, paragrafi 3 riformulohet:

„Mjetet e nevojshme për aftësimin, riaftësimin dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara sigurohen nga buxheti i Kosovës si mjete të themeluesit, mjete të kontributeve të veçanta, mjete të pashpenzuara nga destinime të veçanta, të ardhura të tjera në bazë të ligjit dhe të dispozitave të tjera, si dhe nga donacionet e personave juridikë vendorë dhe të jashtëm”.

Komisioni Funksional

Amendamenti 42

Në nenin 28, paragrafi 1 riformulohet:

“Me gjobë në të holla prej 500 deri 2000 €do të dënohen punëdhënësi dhe personi përgjegjës i tij” dhe vazhdon teksti si në P/ligj.

Komisioni Funksional

Amendamenti 43

Në nenin 29 hiqet fjalia „Agjencion Ekzekutiv i Inspektoratit të Punës “ dhe zëvendësohet me „Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale”.

Komisioni Funksional

Amendamenti 44

Neni 34 riformulohet

„Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës“.

Komisioni FunkSIONAL

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale i miratoi propozimamendamentet për Projektligjin për rehabilitimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara.

4. Të ndryshme

Komisioni e shqyrtoi kërkesën e ish-deputetit të Kuvendit të Kosovës, Ramadan Kelmendi, për ndihmë të pjesshme financiare për shërimin e syve ose për lejimin e shërimit jashtë atdheut.

Pas diskutimeve të deputetëve Komisioni e nxori këtë

Rekomandim

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale e përkrah kërkesën e ish-deputetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Ramadan Kelmendi dhe i rekomandon Kryesisë së Kuvendit ta përkrahë këtë kërkesë dhe ta kërkojë nga Ministria e Shëndetësisë realizimin e saj.

Teuta Hadri – Tha, meqë Ligji për mjekësinë ligjore është kthyer në Qeveri, propozoi që Komisioni për Shëndetësi ta vizitojë Institutin e Mjekësisë Ligjore.

Sadik Idriz – Tha se ky komision nuk është komision funksional për Ligjin për mjekësi ligjore. Sa i përket monitorimit për Ligjin për ushtrimin e veprimtarisë private në shëndetësi, grupi i punës ende nuk ka dalë me një raport për Komisionin. Komisioni do të diskutojë për propozimin se a duhet të organizohet një dëgjim publik për këtë ligj.

Gjylnaze Sylja – Tha se ajo në disa mbledhje ka kërkuar të ftohet për t'u dëgjuar përfaqësuesi i Trustit Pensional. Propozoi që në mbledhjen e radhës Komisioni ta ftojë për ta dëgjuar drejtorin ekzekutiv të Trustit Pensional.

Lidhur me propozimin e deputetes Gjylnaze Sylja Komisioni e nxori këtë

Përfundim

Në mbledhjen e radhës të ftohet për t'u dëgjuar drejtori ekzekutiv i Trustit Pensional.

Mbledhja përfundoi në orën 12:26.

E përgatiti:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryesuesi i Komisionit

Sadik Idriz